


Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore

Viti 2018

Tiranë, më 02 Shtator 2019: Në vitin 2018, indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve bujqësore (2015=100) arriti në 101,2, nga 99,2 që ishte në 2017. Indeksi i çmimeve të prodhimeve bujqësore në vitin 2018 shënoi një rritje me 2,03 %, krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2018, indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore shënoi rritje me 3,5 % dhe indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale shënoi rritje me 0,2 %, krahasuar me një vit më parë.

Fig. 1 Indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve bujqësore, (2015=100) (%)



Ndryshimet vjetore të çmimeve sipas grupeve kryesore:

Rritjen më të madhe vjetore e kanë shënuar çmimet e grupit “Bimë industriale” me 9,52 %, pasuar nga çmimet e grupit “Perime” me 8,92 %, çmimet e grupit “Mish peshë e gjallë” janë rritur me 1,04 % dhe çmimet e grupit “Drufrutorët” me 0,21 %.

Çmimet e grupit “Bimë foragjere” kanë shënuar rënien më të madhe me 6,43 %, pasuar nga çmimet e grupit “Patate” që kanë shënuar rënie me 3,61 %, grupi i “Drithërave” rënie me 0,84 % dhe çmimet e grupit “Qumësht dhe produkte të tjera blegtorale” kanë shënuar rënie me 0,44 %.

Tab. 1 Indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve bujqësore, (2015=100)

Kodi	Produktet	Pesha në % Viti 2016	2016	2017	2018
	Total Prodhime Bujqësore	100	99,9	99,2	101,2
1	Drithëra	4,2	100,3	88,7	87,9
2	Bimë Industriale	0,4	102,1	124,4	133,9
3	Bimë foragjere	3,8	102,1	95,1	88,6
4	Perime	23,2	98,2	98,3	107,2
5	Patate	3,1	106,1	97,7	94,1
6	Prodhimet e drufrutorëve	17,2	99,4	99,7	99,9
6,1	Fruta	8,2	105,8	106,7	106,3
6,2	Agrume	1,0	98,1	100,8	99,7
6,3	Rrush	5,5	99,9	96,3	97,8
6,4	Ullinj	2,5	77,9	83,3	83,4
7	Verë	2,6	108,0	122,5	127,2
8	Vaj Ulliri	1,5	102,0	100,0	104,5
	Prodhimet bimore	56,0	100,0	99,1	102,6
9	Prodhim mishi peshë e gjallë	18,6	99,5	102,2	103,2
9,1	Gjedhi	8,3	99,9	101,0	101,6
9,2	Derra	3,1	101,8	107,1	106,7
9,3	Të imta	5,1	97,2	101,5	105,0
9,4	Shpendë	2,1	100,2	101,4	100,3
10	Qumësht	19,7	101,3	97,6	96,9
10,1	Qumësht lope	14,8	99,4	97,5	97,2
10,2	Qumësht të tjerë	4,9	107,0	97,7	96,1
11	Produkte të tjera blegtorale	5,7	95,0	96,3	96,6
11,1	Vezë	2,8	89,5	99,2	97,5
11,2	Mjalt	2,9	99,8	93,2	95,2
	Prodhimete blegtorisë dhe produkteve të tjera blegtorale	44,0	99,7	99,3	99,5

Tab. 2 Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore, 2016 (2015=100)

(%)

Kodi	Produktet	Pesha në % Viti 2016	Tremujori I 2016	Tremujori II 2016	Tremujori III 2016	Tremujori IV 2016
	Total Prodhime Bujqësore	100	104,3	104,3	95,8	96,6
1	Dritëra	4,2	102,8	106,5	99,4	93,2
2	Bimë Industriale	0,4	99,6	95,8	99,4	111,6
3	Bimë foragjere	3,8	108,5	104,6	98,8	99,0
4	Perime	23,2	113,8	105,4	83,0	91,8
5	Patate	3,1	102,9	125,2	93,7	90,1
6	Prodhimet e drufutorëve	17,2	102,7	115,0	97,8	90,9
6,1	Fruta	8,2	97,7	118,3	99,7	95,9
6,2	Agrume	1,0	120,6	-	-	86,3
6,3	Rrush	5,5	-	-	97,8	104,9
6,4	Ullinj	2,5	97,4	82,3	77,6	74,2
7	Verë	2,6	114,8	110,4	115,7	94,3
8	Vaj Ulliri	1,5	103,5	105,1	104,2	97,8
	Prodhimet bimore	56,0	108,8	109,1	93,5	92,6
9	Prodhim mishi peshë e gjallë	18,6	100,0	98,4	99,3	100,4
9,1	Gjedhi	8,3	100,9	99,9	99,3	99,8
9,2	Derra	3,1	98,6	99,6	104,4	104,4
9,3	Të imta	5,1	100,7	95,1	95,5	98,2
9,4	Shpendë	2,1	97,6	98,9	100,6	103,7
10	Qumësht	19,7	102,3	100,2	100,4	103,1
10,1	Qumësht lope	14,8	99,7	98,8	99,3	100,0
10,2	Qumësht të tjerë	4,9	112,7	104,0	103,5	113,4
11	Produkte të tjera blegtorale	5,7	93,5	89,4	93,7	103,4
11,1	Vezë	2,8	86,8	79,1	86,8	105,5
11,2	Mjalt	2,9	99,4	98,6	100,2	101,1
	Prodhimet e blegtorisë dhe produkteve të tjera blegtorale	44,0	99,9	98,3	99,1	101,8

(-) Produkte sezonale

Tab. 3 Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore, 2017 (2015=100)

(%)

Kodi	Produktet	Pesha në % Viti 2016	Tremujori I 2017	Tremujori II 2017	Tremujori III 2017	Tremujori IV 2017
	Total Prodhime Bujqësore	100	107,0	103,8	90,8	98,2
1	Drihtëra	4,2	91,8	91,1	86,0	86,8
2	Bimë Industriale	0,4	125,2	122,3	122,3	126,9
3	Bimë foragjere	3,8	106,7	97,4	90,9	88,9
4	Perime	23,2	127,7	109,1	70,6	89,3
5	Patate	3,1	103,9	104,3	90,1	88,8
6	Prodhimet e drufutorëve	17,2	101,5	108,7	93,6	100,6
6,1	Fruta	8,2	105,3	109,9	99,4	111,8
6,2	Agrume	1,0	102,3	-	-	100,0
6,3	Rrush	5,5	-	-	89,9	111,6
6,4	Ullinj	2,5	85,8	96,6	95,6	78,9
7	Verë	2,6	119,9	119,6	123,4	124,7
8	Vaj Ulliri	1,5	100,3	97,6	96,8	103,4
	Prodhimet bimore	56,0	114,0	107,5	86,1	96,4
9	Prodhim mishi peshë e gjallë	18,6	102,0	101,5	101,4	103,6
9,1	Gjedhi	8,3	100,7	100,3	101,2	101,8
9,2	Derra	3,1	106,0	108,2	107,4	106,7
9,3	Të imta	5,1	100,5	98,7	99,4	105,7
9,4	Shpendë	2,1	103,9	103,5	98,0	100,2
10	Qumësht	19,7	98,6	98,4	96,0	97,5
10,1	Qumësht lope	14,8	97,9	99,0	96,1	96,9
10,2	Qumësht të tjerë	4,9	101,8	96,7	95,7	99,6
11	Produkte të tjera blegtorale	5,7	99,4	94,6	92,7	98,7
11,1	Vezë	2,8	103,9	98,7	92,0	102,1
11,2	Mjalt	2,9	94,7	90,6	92,6	94,7
	Prodhimet e blegtorisë dhe produkteve të tjera blegtorale	44,0	100,3	99,1	97,7	100,6

(-) Produkte sezonale

Tab. 4 Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore, 2018 (2015=100)

(%)

Kodi	Produktet	Pesha në % Viti 2016	Tremujori I 2018	Tremujori II 2018	Tremujori III 2018	Tremujori IV 2018
Total Prodhime Bujqësore		100	105,2	103,7	96,5	101,0
1	Drithëra	4,2	91,9	92,6	84,6	83,6
2	Bimë Industriale	0,4	137,5	134,4	131,7	132,0
3	Bimë foragjere	3,8	98,0	97,3	84,3	80,6
4	Perime	23,2	116,5	110,1	94,0	111,7
5	Patate	3,1	80,5	86,9	96,5	114,8
6	Prodhimet e drufrutorëve	17,2	125	110,3	93,7	93,6
6,1	Fruta	8,2	132,3	111	97,0	95,9
6,2	Agrume	1,0	120,6	-	-	88,7
6,3	Rrush	5,5	-	-	91,5	112,7
6,4	Ullinj	2,5	102,6	103,9	97,3	75
7	Verë	2,6	122,6	130,2	128,4	125,4
8	Vaj Ulliri	1,5	104,7	104,8	104	104,7
Prodhimet bimore		56,0	110,8	107,7	94,9	101,0
9	Prodhim mishi peshë e gjallë	18,6	103,3	102,7	102,7	104,0
9,1	Gjedhi	8,3	102,0	101,2	101,2	101,9
9,2	Derra	3,1	107,2	106,4	106,2	107,2
9,3	Të imta	5,1	106,3	104,1	104,5	105,3
9,4	Shpendë	2,1	98,0	99,8	99,8	103,7
10	Qumësht	19,7	96,9	96,8	96,8	97,2
10,1	Qumësht lope	14,8	97,5	97,1	96,7	97,4
10,2	Qumësht të tjerë	4,9	94,3	95,9	96,9	96,5
11	Produkte të tjera blektorale	5,7	97,0	93,2	94,9	101,4
11,1	Vezë	2,8	98,6	90,3	94,2	107,0
11,1	Mjalt	2,9	94,8	95,0	95,0	96,0
Prodhimet e blegtorisë dhe produkteve të tjera blektorale		44,0	99,8	98,6	98,9	101,0

(-) Produkte sezonale

Metodologjia

Indekset e çmimeve të prodhimeve bujqësore llogariten bazuar në standartet dhe rregullat të përshkuar në Manualin e Çmimeve të Produkteve Bujqësore të Eurostat. Çmimet mblidhen nga Anketa Mujore për Produktet Bujqësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Mbledhja e të dhënave kryet pranë fermave, tregjeve të gjësë së gjallë, tregjet e shumicës dhe vende të tjera ku prodhimet bujqësore mund të grumbullohen. Informacioni merret vetëm për çmimet në nivel ferme për produktet vendase, duke përjashtuar taksat. Ato janë llogaritur në Lek, kurse njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë.

Prodhimet që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të produkteve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe ato blegtorale. Për prodhimet bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë industriale, bimë foragjere, perime, patate dhe drufrutorë. Për prodhimet blegtorale, çmimet janë grumbulluar për blegtorinë dhe për prodhimet blegtorale. Çmimet grumbullohen për katër kategori kryesore të kafshëve: gjedhi, të imta, derra dhe shpendë. Për prodhimet blegtorale, çmimet janë grumbulluar për kategoritë: qumësht, vezë dhe mjaltë.

Skema e peshave në Indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore

Për llogaritjen e indeksit të çmimeve të produkteve bujqësore përdoret edhe skema e peshave. Vlera e peshës bashkëngjitur në çdo indeks elementar dhe në indeksin e agreguar është e barabartë me vlerën e shitjes së produkteve (pa përfshirë TVSH) gjatë periudhës bazë (2015=100), bazuar kjo në metodologjinë ndërkombëtare. Peshat përdoren gjithashtu dhe për të bashkuar nëngrupet e indekseve në nivel grupi dhe për të bashkuar indeksin në nivel grupi me totalin. Peshat e çmimeve të produkteve bujqësore konform parimeve të Llogarive Ekonomike në Bujqësi (në konceptin e çmimeve të prodhimit). Peshat totale dhe peshat tremujore të këtyre çmimeve janë fikse gjatë periudhës bazë. Skema e peshave për Indeksin e Çmimeve Bujqësore ndryshon çdo 5 vite.

Llogaritja e indeksit elementar të çmimeve

Indeksi elementar llogaritet sipas formule në vijim duke përdorur çmimet mesatare absolute.

$$R_i^t = \frac{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^t}{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^0}, 100$$

R_i^t : Indeksi elementar për muajin "t" dhe prodhimin "i"

P : Çmimet e grumbulluara

i : Prodhimi "i"

j : Çmimi i regjistruar për prodhimin (në përgjithësi çmimi për rrethin 1,2,...,n)

t : Muaji i vëzhguar

o : Muaji bazë

Llogaritja e indeksit të agreguar të çmimeve

Indeksi të agreguar për totalin e prodhimeve ose nëngrupeve të indeksit të prodhimeve është llogaritur duke shfrytëzuar formulën në vijim:

$$I^t = \sum \left(R_i^t \cdot \frac{w_i^o}{\sum w_i^o} \right) \cdot 100$$

I : Indeksi i agreguar për periudhën "t"

w_i^o : Faktori peshues në periudhën bazë për prodhimin "i"

i : Prodhimi "i"

t : Muaji i vëzhguar

o : Muaji bazë